

Emertimi dhe Forma ligjore	<u><b>TOLIMO , Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar</b></u> <u><b>Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar</b></u>
NIPT -i	<b>J81623004A</b>
Adresa e Selise	<u><b>TIRANE Rr.Siri Kodra Blloku I Magazinave</b></u> <u><b>Tirane</b></u>
Data e krijimit	<b>19/09/1997</b>
Nr. i Regjistrimit Tregëtar	
Veprimtaria Kryesore	<u><b>Import -eksport ,tragetim te artikujve industriale,</b></u> <u><b>Prodhim Bojrash,Mobileri dhe paisje te ndryshme</b></u>

# PASQYRAT FINANCIARE

## 2020

Pasqyra Financiare jane	<u><b>Individuale</b></u>
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne	<u><b>Leke</b></u>
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare	Nga <b>1 JANAR 2020</b> Deri <b>31 DHJETOR 2020</b>
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare	<u><b>Mars 2021</b></u>

	<b>FAQE</b>
<b>RAPORTI PERMBLEDHES PER PASQYRAT FINACIARE</b>	<b>2 - 6</b>
<b>BILANCI KONTABËL</b>	<b>7</b>
<b>PASQYRA E TË ARDHURAVE E SHPENZIMEVE</b>	<b>8</b>
<b>PASQYRA E CASH FLOW-t</b>	<b>9</b>
<b>PASQYRA E LËVIZJEVE NË KAPITAL</b>	<b>10</b>
<b>PASQYRAT E AQT</b>	<b>11</b>
<b>SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>12 - 21</b>



## RAPORTI I PERMBLEDHES PËR PASQYRAT FINANCIARE 12-MUJORI 2020

Administratorit te Tolimo sh.p.k.

### INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqeria TOLIMO Shpk eshte e regjistruar si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor, Tirane me Nr. 17757, date 22/09/1997 dhe ka nje kapital prej 78,000,000 LEKE, i ndare ne 100 kuota .

Kjo shoqeri eshte ne pronesi te ortakeve:

- Z.Torpe MAZNIKU 1 kuote te kapitalit qe eshte 50 % , njekohesisht administrator i saj.
- Znj.Emanuela SHPATI 1 kuote te kapitalit pra 30%.
- Z.Ilirjan HOXHA 1 kuote te kapitalit pra 20 %

Ne 31 Dhjetor 2020 kjo shoqeri e ushtronte aktivitetin prane selise qendrore te kompanisë e cila ndodhet në Tiranë, Shqipëri ne Rr.Siri Kodra Blloku i magazinave.

Aktiviteti kryesor i kompanisë është tregetim me shumice e pakice mallra dhe materiale industriale te mobilerise dhe prodhim Bojrash.

Ne 31 Dhjetor 2020 shoqeria kishte 9 punonjes.

### PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABILE

#### 2.1 Parimi i Përshtatshmërisë

Pasqyrat financiare janë pregatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar (SKK) dhe interpretimet e saj të adaptuara nga Bordi i Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (BSKK).

#### 2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Politikat kryesore kontabile janë përmendur më poshtë.

#### 2.3 Të ardhurat

E ardhura matet me vlerën e tregut për atë që do merret apo është marrë dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet e siguruar gjatë rrjedhës normale të biznesit, pasi ti jenë zbritur tatimi mbi vlerën e shtuar për shitjet dhe uljet në çmim. E ardhura njihet kur risqet dhe përfitimet për produktet dhe shërbimet e sipër përmendura janë transferuar tek klienti.

##### 2.3.1 Shitja e produkteve

E ardhura nga shitja e produkteve njihet kur plotësohen të tëra kushtet e mëposhtme:

- Kompania ka transferuar tek blerësi risqet dhe përfitimet kryesore të pronësisë së produkteve;
- Kompania ruan një përfshirje manaxheriale të vazhdueshme zakonisht deri në shkallën e nivelit të pronësisë jo kontroll efektiv mbi produktet e shitura;

- Vlera e të ardhurës mund të matet lehtësisht;
- Ka mundësi që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të jenë flukse hyrëse në kompani; dhe
- Kostot e ndodhura ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin mund të maten lehtësisht.

### 2.3.2 Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi janë rrjedhëse mbi bazë kohore, duke ju referuar principalit gjendje dhe normës së interesit efektive të aplikueshme, e cila është norma që skonton flukset e ardhshme të vlerësuara të parasë me jetën e prituri të aktivitetit financiar dhe me vlerën neto të mbartur të atij aktivi.

### 2.4 Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve. Në çdo datë mbyllje të bilancit kontabël, zërat monetarë në monedhë të huaj rikonvertohen në Lekë me kursin në datën e mbylljes së bilancit. Zërat jomonetarë që mbarten me vlerën e tregut të mbajtura në valutë të huaj rikonvertohen me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e tregut. Zërat jomonetarë që maten në termat e kostos historike në valuta të huaja nuk rikonvertohen.

Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga konvertimi i zërave monetarë dhe nga rikonvertimi i zërave monetarë përfshihen në pasqyrën e të ardhurave të periudhës.

### 2.5 Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin

### 2.6 Tatimi aktual

Tatimi aktual bazohet në fitimin e tatueshëm të vitit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në pasqyrën e të ardhurave të konsoliduar sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e ardhshme dhe ai përjashton gjithashtu zëra që nuk taten apo zbriten asnjëherë.

### 2.7 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara gjatë kohës së ndërtimit për prodhim, dhënie me qera ose qëllime të tjera administrative, apo për qëllime të papërcaktuara akoma, mbarten me kosto, minus çdo humbje zhvlerësimi të njohur.

Toka njihet fillimisht me kosto. Matja e mëvonshme e vlerës së tokës bazohet në shumën e rivlerësuar. Toka nuk amortizohet.

Ndërtesat njihen fillimisht me kosto. Matja e mëvonshme e vlerës së ndërtesave bazohet në shumën e rivlerësuar.

Mobiljet dhe pajisjet pasqyrohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbje zhvlerësimi të akumuluar përgjatë gjithë jetës së tyre duke përdorur metodën e vlerës së mbetur.

Jetëgjatësia për secilën klasë të aktiveve është si më poshtë:

<u>Kategoria</u>	<u>Norma e amortizimit</u>
Ndërtesa	5%
Mjete transporti	20%
Mjete me lizing financiar	20%
Mobilje dhe Paisje	20%

Fitimi ose humbja që rrjedhin nga shitja apo dalja jashtë përdorimit e zërave të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës së mbartur të aktivitetit dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave.

## 2.8 Inventarët

Inventarët pasqyrohen me vlerën më të vogël mes koston mesatare dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja përfshin çmimin e blerjes dhe një masë të caktuar të taksave doganore, rabatet dhe taksa të tjera të parimbursueshme të vlerësuara duke përdorur koston mesatare. Inventarët janë mallrat primare për rishitje.

## 2.9 Aktivitetet dhe detyrimet financiare

### 2.9.1 Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera kërkesa për arkëtim nuk mbartin ndonjë interes dhe pasqyrohen me vlerë nominale të reduktuar me shumën e vlerave të vlerësuara si të paarkëtueshme. Shumat e paarkëtueshme vlerësohen në bazë të vjetërsisë së tyre dhe eksperiencës së mëparshme.

### 2.9.2 Detyrimet financiare

Detyrimet financiare, dukë përfshirë huatë, fillimisht maten me vlerën e tregut, koston neto të transaksionit dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit në bazë të normës efektive të interesit.

## 2.10 Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre për qëllime të flukseve të parasë përfshijnë mjetet monetare në arkë dhe në bankë dhe investime të tjera afat-shkurtra me likuiditet të lartë që janë lehtësisht të konvertueshme në një vlerë të njohur parash dhe janë subjekt i një risku të papërfillshëm të ndryshimit të vlerës.

## 2.11 Parimi i vijëmisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi supozimin se kompania është në vijëmi dhe do të vazhdojë operacionet e saj për një periudhë të parashikueshme

## PARIME TE PERGJITHSHME

Situata financiare e prezantuar në pasqyrat e bilancit, të ardhurave dhe shpenzimeve, fluksit të parase dhe pasqyrës së levizjes së kapitaleve të veta është mbështetur në parimet e përcaktuara në Ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe është adoptuar sipas Standarteve Kombëtare të Raportimit Financiar (SKK) duke bërë dhe interpretimet respektive për pasqyrat financiare të vitit 2020 (12-mujori).

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, ku efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera janë plotësuar në pasqyrat financiare kur ato kanë ndodhur duke u regjistruar në kontabilitet dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhës kontabël 2020. Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabël dhe sistemin e tij, mbahen në mënyrë të kompjuterizuar, me anë të një programi të kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare dhe monedha raportuese.  
Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise.

#### **Mjete monetare dhe ekuivalente me to**

Mjete monetare dhe ekuivalente me to perfshijne gjendjen e arkës dhe mjetet monetare te depozituara ne disa banka tregtare : Credins Bank, Raiffeisen Bank,

Transaksionet me monedhat e huaja

a) Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim).

Pasqyrat e individuale financiare raportohen ne LEKE shqiptar (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1 EUR	123.70 Leke	121.77 Leke
1 USD	100.84 Leke	108.64 Leke

#### **RREGULLAT DHE MENYRA TE ZBATUARA**

Pershtatshmëria e normave te amortizimit, metodave te amortizimit dhe perllogaritjes se vlerave te rikuperimit rishihet nga shoqeria cdo vit.

Per secilen klase te aktiveve te qendrueshme te trupezuar si afatshkurter dhe afatgjate, shoqeria ka zbatuar norma amortizimi ne baze te jetes se dobishme te secilit prej tyre.

Shpenzimet jane regjistruar ne te njyten periudhe kontabel, si dhe te ardhurat e lidhura me to.

Aktivet afatgjata gjate vitit 2020 jane te regjistruara ne shumen 25,500,955 leke (AQT).

Ndertesat, makinerite, paisjet dhe aktive te qendrueshme te tjera jane paraqitur edhe vlera e amortizim te tyre.

Aktivet afatshkurtra jane 132,530,620 leke perfaqesojne inventare,kerkesa te arketueshme per gjendja e TVSH kreditore , likujditetet, kerkesa per arketim te klienteve, ashtu si paraqiten ne bilanc.

-Likujditetet dhe vlera te tjera ne arke .

Shoqeria ne fund te 12 mujorit 2020 ka pasur likujditete ne Banka te ndryshme ne shumen 705,113 leke.

Detyrimet afagjata perfshijne:

Ne fund te 12-mujorit 2020 rezulton qe shoqeria te kete detyrime afatgjata ne shumen 44,261,043 leke, perfaqsojne:

- Detyrime ndaj ortakeve te shoqerise qe perfaqeson fondin e kredituar per shoqerine nga ortaku ne vitet e me parshme dhe eshte paguar dividend ne shumen : 44,261,043 leke

Detyrimet afashkurtra, ne fund te 12 mujorin e 2020 jane 22,862,256 leke .

Ne kete grup detyrimesh e perbejne:

- Detyrime kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore qe likujdohen ne muajin pasardhes, sipas listepageses ne shumen 74,130 leke.

- Detyrime tatimit mbi te ardhurat nga punesimi qe likujdohen ne muajin pasardhes, sipas listepageses ne shumen 6,420 leke.

-Detyrime per llogari te pagueshme ndaj furnitoreve te shoqerise ne Shumen 20,368,744 leke.

-Detyrime ndaj paga personel ne shumen : 879,651 leke

-Detyrime ndaj Huara te Tjera ne shumen : 1,533,311leke

Te ardhurat e gjeneruara per 12-mujorin 2020 jane ne shumen 65,871,413 Leke dhe perbehen nga:  
Shitje te mallrave ,produkt i gatshem jane ne shumen : 59,554,736 leke  
Te ardhura nga shitje se AQT jane ne shumen : 3,590,117 leke  
Te ardhura nga diferenca pozitive nga kembimi ne shumen 2,726,560 leke

Shpenzimet e realizuara faktikisht perfaqesojne nje shume totale 63,120,052 leke.  
Ne zerin e shpenzimeve, sipas zerave qe perfshihen peshe kryesore zene shpenzimet per blerje mallradhe matriale te para dhe ndihmese dhe inventar i imet per sherbimet e ofruara,si dhe shpenzimet administrative e zene shpenzime per paga,qera, shpenzime telekomunikacion.taksa bashkie .  
Shpenzimet janë regjistruar në të njëjtën periudhë kontabël, si dhe të ardhurat e lidhura me to.

Kapitali aksionar i shoqerise eshte 78,000,000 leke.  
Per 12-mujorin rezultati i aktivitetit eshte me fitim, qe ndikon ne rritje te kapitalit te shoqerise.

Ne fund te 12-mujorit 2020 shoqeria rezulton ne Flukse monetare te siguruara nga operacionet ne vleren 2,751,360 Leke

Ne fund te 12-mujorit 2020 shoqeria ka nje gjendje se likujditeteve ne shumen 705,113 leke.

Bashkelidhur jane pasqyrat financiare te cilat prezantojne ne raporte dhe tregues financiare ecurine e aktivitetit dhe tendencen e tij.

Tiranë, Shqipëri  
Mars 2021



**BILANCI KONTABËL**  
**PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2020**

	Shenime	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
<b>AKTIVE</b>			
<i>Aktive afatgjata</i>	<b>1</b>		
<b>Aktive të qëndrueshme të trupëzuara</b>		<b>25,500,955</b>	<b>25,761,743</b>
Toka, terrene, ndertime e instal. Te pergj.		4,000,000	4,000,000
Istalime tek makineri, paisje, vegla pune		25,857,433	35,186,030
Mjete Transporti		18,072,561	17,236,687
Paisje kompjuterike & Zyre		8,164,551	8,164,551
Amortizime		(30,593,590)	(38,825,525)
		<u><b>25,500,955</b></u>	<u><b>25,761,743</b></u>
<i>Aktive afatshkurtra</i>	<b>2</b>		
Inventarë		121,037,830	125,814,572
Llogari të arkëueshme		4,652,181	2,747,549
Kerkesa te tjera te arketueshme		6,135,496	6,305,323
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre		705,113	581,689
		<u><b>132,530,620</b></u>	<u><b>135,449,133</b></u>
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<u><b>158,031,575</b></u>	<u><b>161,210,876</b></u>
<i>DETYRIME DHE KAPITALI AKSIONER</i>			
<i>Kapitali aksioner</i>	<b>3</b>		
Kapitali i aksionar		78,000,000	78,000,000
Rezervat ligjore		882,863	882,863
Fitimi i mbartur		9,698,801	7,606,912
Humbja e vitit ushtrimor		2,326,612	2,091,889
<b>Total kapitali aksioner</b>		<u><b>90,908,275</b></u>	<u><b>88,581,664</b></u>
<i>Detyrime afatgjata</i>	<b>4</b>		
Kredi e ortakeve		44,261,043	44,261,043
<b>Totali detyrime afatgjata</b>		<u><b>44,261,043</b></u>	<u><b>44,261,043</b></u>
<i>Detyrime afatshkurtra</i>	<b>5</b>		
Huara te Tjera		1,533,311	1,533,311
Llogari të pagueshme		20,368,744	25,786,276
Detyrime të tjera		960,201	1,048,582
<b>Totali detyrimeve afatshkurtra</b>		<u><b>22,862,256</b></u>	<u><b>28,368,169</b></u>
<b>TOTALI DETYRIME DHE KAPITALI AKSIONER</b>		<u><b>158,031,574</b></u>	<u><b>161,210,876</b></u>


*Shënimet shoqëruese në faqet 12 deri më 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare*



**PASQYRA E TË ARDHURAVE  
PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2020**

	Shenime	Më 31 Dhjetor 2020	Më 31 Dhjetor 2019
Te ardhura	6	63,144,853	59,171,453
Blerje Mallra	7	(47,709,389)	(44,398,362)
<b>Shitjet neto</b>		<b>15,435,464</b>	<b>14,773,091</b>
Shpenzime administrative	8	(14,130,805)	(11,103,873)
Te ardhura finaciare		2,726,560	1,157,838
Kosto Finaciare		0	0
Amortizimi		(1,279,858)	(2,332,050)
<b>FITIMI PARA TAKSAVE</b>	9	<b>2,751,360</b>	<b>2,495,006</b>
Shpenzime te pa njohura		80,299	192,444
<b>FITIMI FISKAL</b>		<b>2,831,659</b>	<b>2,687,450</b>
% e tatim Fitimit		15%	15%
Taksa e Tatim Fitimit		424,749	403,118
<b>FITIMI I VITIT USHTRIMOR</b>		<b>2,326,612</b>	<b>2,091,889</b>

*Shënimet shoqëruese në faqet 12 deri më 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare*



**PASQYRA E CASH FLOW-t**  
**PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2020**

<b>Pasqyra e Cash Flow-t</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Cash Flow nga aktiviteti I shfrytzimit		
(Humbje)/ fitimi para tatimit	(231,842)	1,337,168
Sistemim per:		
Rezultati Financiar neto (e ardhur) shpenzim	2,657,461	1,157,826
Amortizimi	(8,231,935)	2,332,050
Provizionet	0	0
Humbje nga shitja e AQT	325,741	0
<b>Flukse monetare te siguruara nga operacionet</b>	<b>(5,480,574)</b>	<b>4,827,044</b>
(Shtesa)/ Pakesime ne gjendjet e inventarit	4,776,742	(3,079,352)
(Shtesa)/ Pakesime ne gjendjen e Kerkesave per Arketim	(1,734,806)	(117,028)
(Shtesa)/ Pakesime ne gjendjen e Detyrimeve	(5,505,913)	4,922,833
<b>Cash Flow nga aktiviteti</b>	<b>(7,944,550)</b>	<b>6,553,497</b>
Interesa te Paguara	0	0
Tatim mbi Fitimin i paguar	(424,749)	(403,118)
<b>Flukse monetare te siguruara nga aktivitetet operative</b>	<b>(8,369,299)</b>	<b>6,150,380</b>
Cash Flow nga aktiviteti i Investimeve		
Blerja e AQT	8,492,723	(6,414,811)
Shitje e AQF	0	0
Dividente te fituar nga shitja e AQF		
Interesa te fituara	0	12
<b>Cash Flow Neto (I perdorur) nga aktiviteti I investimit</b>	<b>123,424</b>	<b>(264,419)</b>
Cash Flow nga aktiviteti I financimit		
Divident te paguar		
Shtesa te kapitalit te Shoqerise		
<b>Cash Flow Neto (I perdorur) nga aktiviteti I financimit</b>	<b>123,424</b>	<b>(264,419)</b>
Shtesa /(Pakesime) ne gjendjen e likuiditeteve		
Likujditetet dhe ekuivalente me 1 Janar	581,689	846,108
<b>Likujditetet dhe ekuivalente me 31 Dhjetor</b>	<b>705,113</b>	<b>581,689</b>

*Shënimet shoqëruese në faqet 12 deri më 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare*

**PASQYRA E LËVIZJVE NË KAPITAL  
PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2020**

**PASQYRA E LËVIZJVE NË KAPITAL**

Pershkrimi	Kapitali Themeltar	Rezervat	Fitimi i Akumuluar	Fitimi i vitit ushtrimor	TOTAL
Me 1 Janar 2019	78,000,000	882,863	7,606,912	-	86,489,775
Rezultati neto viti 2019					
Dividente te Paguar				2,091,889	2,091,889
Rezervat					
Me 31 Dhjetor 2019	78,000,000	882,863	7,606,912	2,091,889	88,581,664
Me 01 Janar 2020	78,000,000	882,863	9,698,801		88,581,664
Shtesa ne kapital					
Rezultati neto viti 2020				2,326,612	2,326,612
Dividente te Paguar					
Rezervat					
Tatim mbi ndarje dividend					
Me 31 DHJETOR 2020	78,000,000	882,863	-	2,326,612	90,908,275



TOLIMO sh.p.k. NIPT: J81623004A  
Raporti 12 Mujor i vitit 2020 dhe Pasqyrat Financiare

**PASQYRAT FINANCIARE  
PËR PERIUHDHEN JANAR -DHJETOR 2020**

**AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA**

Pershkrimi		Toka	Ndertesat	Makineri Pajisje	Automjetet	pajisje Zyre	TOTAL
Bilanci i Celjes 01.01.2020	+	2,000,000	2,000,000	35,186,030	17,236,687	8,164,551	64,587,268
Bilanci i Celjes 01.01.2020	+	0	895,862	26,897,180	6,256,331	4,776,152	38,825,525
Bilanci i Celjes 01.01.2020	+						0
Hyrjet 2020	+			183,195	4,100,250		4,283,445
Daljet 2020	-			9,511,792	3,264,376		12,776,168
Riklasifikim i Aktiveve	+/-						0
Provizionet	+						0
Amortizimi i Vitit Ushtrimor	+				771,598	508,260	1,279,858
Rimarje e Amortizimit	-			9,511,792			9,511,792
Rimarje e Provizioneve	-						0
Riklasifikim i Amortizimeve	+/-						0
Bilanci i Mbylljes 31.12.2020		2,000,000	2,000,000	25,857,433	18,072,561	8,164,551	56,094,545
Bilanci i Mbylljes 31.12.2020		0	895,862	17,385,387	7,027,929	5,284,412	30,593,590
Bilanci i Mbylljes 31.12.2020		2,000,000	1,104,138	8,472,046	11,044,632	2,880,139	25,500,955

TOLIMO sh.p.k. NIPT: J81623004A  
Raporti 12 Mujor i vitit 2020 dhe Pasqyrat Financiare

**SHENIMET SHPJEGUESE**

**1. AKTIVE AFATGJATA**

Aktivet afatgjata perfaqesojne makineri dhe paisje pune,mjete te transportit,paisje zyre dhe informatike.

Mjetet te transportit, paisjet dhe aktive te qendrueshme te tjera jane paraqitur edhe vlera e amortizim te tyre.

Aktive Afatgjata më 31Dhjetor 2020 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Toka, terrene,ndertime e instal. Te pergj.	4,000,000	4,000,000
Istalime tek.makineri,paisje,vegla pune	25,857,433	35,186,030
mjete transporti	18,072,561	17,236,687
Paisje kompjuterike & Zyre	8,164,551	8,164,551
Amortizime	(30,593,590)	(38,825,525)
<b>TOTALI</b>	<b>25,500,955</b>	<b>25,761,743</b>

**2. AKTIVE AFATSHKURTRA**

Aktivet afatshkurtra jane 132,530,620 leke perfaqesojne inventare,pagese te pullave te akcizes per veren nga importi ,gjendjen kreditore te tvsh-se, kerkesa per arketim te klienteve,furnitore,likujditetet, ashtu si paraqiten ne bilanc.

Aktive Afatshkurter më 31Dhjetor 2020 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Inventarë	121,037,830	125,814,572
Llogari të arkëueshme	4,652,181	2,747,549
Kerkesa te tjera te arketueshme	6,135,496	6,305,323
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	705,113	581,689
<b>TOTALI</b>	<b>132,530,620</b>	<b>135,449,133</b>

**PASQYRAT FINANCIARE**  
**PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2020**

---

**2.1 KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME**

Kerkesa te tjera te arketueshme më 31Dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31</b>	<b>Më 31</b>
	<b>Dhjetor 2020</b>	<b>Dhjetor 2019</b>
Kerkesa te arketueshme per TVSH	6,092,550	6,305,323
Kerkesa te tjera per Tatim Mbi Fitimin	42,946	0
<b>TOTALI</b>	<b>6,135,496</b>	<b>6,305,323</b>

**2.2 PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ**

Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31Dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31</b>	<b>Më 31</b>
	<b>Dhjetor 2020</b>	<b>Dhjetor 2019</b>
Arka ne Leke	29,399	59,944
Banka	675,714	521,745
<b>TOTALI</b>	<b>705,113</b>	<b>581,689</b>

**3. KAPIALI AKSIONER**

Kapitali Aksioner më 31Dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31</b>	<b>Më 31</b>
	<b>Dhjetor 2020</b>	<b>Dhjetor 2019</b>
Kapitali aksioner		
Kapitali i nënshkruar	78,000,000	78,000,000
Rezervë ligjore	882,863	882,863
Fitimi i mbartur	9,698,801	7,606,912
Fitimi i ushtrimit	2,326,612	2,091,889
<b>Total kapitali aksioner</b>	<b>90,908,275</b>	<b>88,581,664</b>

Kapitali i shoqerise me 31Dhjetor 2020 eshte 90,908,275 leke shume kjo qe perbehet nga kapitali i regjistruar,rezervat ligjore,fitime te mbartura dhe fitimi i vitit 2020.



**PASQYRAT FINANCIARE  
PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2020**

**4. DETYRIME AFATGJATA**

Detyrimet afatgjata më 31 Dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Kredi e ortakeve	44,261,043	44,261,043

Shoqëria në fund të 12-mujorit 2020 rezulton që shoqëria të ketë detyrime afatgjata; ndaj ortakeve të shoqërisë, në shumën 41,681,062 leke, që përfaqëson fondin e kredituar për shoqërinë nga ortakët.

Keto vijne si rezultat i shpërndarjes së dividendit të shoqërisë, sipas vendimit të asamblesë së vitit 2009 dt. 29/06/2010.

**5. DETYRIME AFATSHKURTRA**

Detyrimet afatshkurtra më 31 Dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

<b>Detyrime Afatshkurter</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Huara të Tjera	1,533,311	1,533,311
Llogari të pagueshme	20,368,744	25,786,276
Detyrime të tjera	960,201	1,048,582
<b>TOTALI</b>	<b>22,862,256</b>	<b>28,368,169</b>

**5.1 PARADHENIE TE MARRA**

Detyrimet për paradhenie të marra më 31 Dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Huadhenie nga Saka Mobilje	1,533,311	1,816,461

**5.2 DETYRIME TË TJERA**

Detyrimet të tjera tatimore më 31 Dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Personeli	879,651	810,302
Sigurime shoqërore dhe të ngjashme	74,130	81,387
Detyrime Tatimore (TAP)	6,420	6,420
Shteti -tatime dhe taksa (tatim Fitimi)	0	150,473
<b>TOTALI</b>	<b>960,201</b>	<b>1,048,582</b>

**PASQYRAT FINANCIARE  
PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2020**

**6. TE ARDHURAT**

Te ardhurat e periudhes se vitit ushtrimor deri më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Nga shitja e mallrave	59,238,396	57,449,208
Shitje e produkt i gatshem	316,340	1,691,621
Shitje Materiale furniturash	0	30,625
Te ardhura nga shitje se AQT	3,590,117	0
Diferenca pozitive nga kembimi	2,726,560	1,157,826
<b>TOTALI</b>	<b>65,871,413</b>	<b>60,329,291</b>

**7. KOSTO TE SHIJTEVE**

Kostot e shitjes më 31 Dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Blerje mallrash & materialeve te para e te tjera	47,709,389	44,398,362

**8. SHPENZIME ADMINISTRATIVE**

Shpenzimet administrative te periudhes se vitit ushtrimor deri më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Pagat e personelit	3,722,955	3,957,072
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	621,732	660,828
Lende Djegese	54,702	91,001
Trajtime te pergjithshme	405,835	1,000,000
Mirembajtje dhe riparime	186,440	118,233
Kancelari	4,000	38,283
Sherbim Agjenci Doganore	5,500	
Shpenzime postare e telekomunikacion	272,164	287,563
Sherbim per Transporte	2,279,743	2,391,248
Sherbime bankare	171,476	219,272
Taksa dhe tarifa vendore	274,745	399,000
Tatime te tjera_ Taksa Doganore	2,620,339	1,567,940
Gjoha dhe demshperblime	11,200	599
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	166,500	372,833
Vlera kontabel e AQ te shitura	3,264,376	-
Diferenca negative nga kembimi	69,099	-
<b>TOTALI</b>	<b>14,130,805</b>	<b>11,103,873</b>



**9. FITIMI I AKTIVITETIT USHTRIMOR**

Tatimi aktual bazohet në fitimin e tatueshëm të vitit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në pasqyrën e të ardhurave të konsoliduar sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e ardhshme dhe ai përjashton gjithashtu zëra që nuk taten apo zbriten asnjëherë.

Detyrimi i kompanisë për tatim fitimin llogaritet duke përdorur normat e tatim fitimit që janë në fuqi apo që kanë hyrë në fuqi në datën e bilancit kontabël.

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
<b>FITIMI PARA TAKSAVE</b>	2,751,360	2,495,006
Shpenzime te pa njohura	80,299	192,444
<b>FITIMI FISKAL</b>	<b>2,831,659</b>	<b>2,687,450</b>
% e tatim Fitimit	15%	15%
<b>Taksa e Tatim Fitimit</b>	<b>424,749</b>	<b>403,118</b>
<b>FITIMI I VITIT USHTRIMOR</b>	<b>2,326,612</b>	<b>2,091,889</b>

**10.1 SHPENZIME TE PANJOHURA**

Shpenzimet e panjohura fiskalisht te periudhes se vitit ushtrimor deri më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si vijon:

	<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2019</b>
Gjoha dhe demshperblime & Shpenzime te tjera	11,200	599
Diferenca pozitive nga kembimi	69,099	191,845
<b>TOTALI</b>	<b>80,299</b>	<b>192,444</b>

**INFORMATA DHE SQARIME TE NEVOJSHME**

**F I R M A**

**DREJTUESI**

**Torpe MAZNIKU**

